



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË**

Numri i lëndës: 2022:094585  
Datë: 23.12.2024  
Numri i dokumentit: 06642843

**PPP.nr.86/2024**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Dega në Podujevë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, gjyqtarja Adelina Jusufi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit B. Sh., i përfaqësuar nga Shoqëria e Avokatëve KLINAKU&ASSOCIATES L.L.C, nga Prishtina, Blv. Dëshmorët e Kombit, Ulpianë, C-2, 2;6, Hy.101, kundër debitorit Komuna e Podujevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me adresë në rr. “Nuhi Gashi”, Podujevë, për borxh në vlerë prej 861.44 €, duke vendosur lidhur me prapësimin, jashtë seancës gjyqësore, me datë 23.12.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. REFUZOHET** si i pa bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Podujevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me adresë në rr. “Nuhi Gashi”, Podujevë, i ushtruar me dt.28.10.2024, kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.9370/2024, i datës 10.10.2024.

**II. MBETET** në fuqi Urdhri P.nr. 9370/2024 të datës 10.10.2024 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë.

**A r s y e t i m**

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit B. Sh., i përfaqësuar nga Shoqëria e Avokatëve KLINAKU&ASSOCIATES L.L.C, nga Prishtina, Blv. Dëshmorët e Kombit, Ulpianë, C-2, 2;6, Hy.101, në bazë të titullit ekzekutiv – Aktgjykimit C.nr. 440/2022 i

dt. 11.04.2024, i plotfuqishëm me datë 26.04.2024 dhe i ekzekutueshëm prej datës 27.05.2024, ka nxjerr urdhrin P.nr. 9370/2024 të datës 10.10.2024, me të cilin ka caktuar zbatimin e përmbarimit, ndaj debitorit Komuna e Podujevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, duke e detyruar debitorin që nga mjetet financiare të tij ti bartë në xhirollogarinë e përmbaruesit privat shumën prej 472.44 euro, në emër të borxhit me kamatë prej 8 % nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimit e deri në përmbarimin definitiv dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, si dhe të detyrohet debitori që të paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se nuk ka buxhet për pagesën e këtij obligimit, pasi që në nenin 46 të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021 është paraparë se MASHT-i dhe SBASHK-u angazhohen bashkërisht me Ministrinë e Financave për ndarjen e mjeteve financiare për pagesën e obligimeve që rrjedhin nga neni 35 në paragrafët e këtij neni të kësaj kontrate, andaj e paditura nuk ka buxhet për kryerjen e obligimeve të punëtorëve të arsimit, me propozimin që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhri për përmbarim.

Kreditori, në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka deklaruar se pretendimi se nuk ka buxhet, por për të njëjtën nuk ka paraqitur as një provë, se përmbarimja e prapësimit nuk përmbar asnjërin nga kushtet sipas nenit 71 të LPP-së, nuk ka paraqitur asnjë provë siç parashihet të paraqiten me nenin 69 par.4 të LPP-së dhe së është paraqitur vetëm për të zvarritur procedurën, si dhe të detyrohet debitori t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore, me propozimin që të refuzohet prapësimi i debitorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorëve të paraqitura në prapësim dhe pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së, gjeti se, prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të mbetet në fuqi, dhe atë për shkak se si në vijim: Gjykata vlerëson se, organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së, i cili përcakton se: “Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”

Gjykata gjeti se dokumenti përmbarimor – Aktgjykimi C.nr. 440/2022 i dt. 11.04.2024, i plotfuqishëm me datë 26.04.2024 dhe i ekzekutueshëm prej datës 27.05.2024, i plotëson kushtet

ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së, i cili përcakton se: “Propozimi për përbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përbarimi, kërkuesi i përbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit– vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përbarimi, objekti i përbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përbarimit”.

Gjykata, gjeti po ashtu se aktgjykimi në bazë të së cilit përbaruesi privat ka lejuar përbarimin dhe si i njëjti në kuptim të nenit 22 paragrafit 1, pika 1.1 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përbarues mbi bazën e të cilit mund të caktohet përbarimi, në këtë çështje përbarimore, ndërsa sipas nenit 24 par.1 të LPP-së, thuhet se: “Vendimi gjyqësor me të cilën është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje është i përbarueshëm po qe se ka marrë formën te prerë si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare”, po ashtu gjykata gjeti se aktgjykimi në fjalë i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1 të LPP-së, e sipas të cilit: “Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, pra ky dokument përbarimor i përmban të gjitha të dhënat për tu përbaruar në procedurën e përbarimit, me këtë aktgjykimin është urdhëruar përmbushja e detyrimit në të holla, nga ana e debitorit, e më gjerësisht me përshkrimin e bërë si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se urdhri për përbarim i caktuar mbi bazën e titullit ekzekutiv – Aktgjykimi i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument përbarues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përbarimit, ngase janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.1, nenit 24 par. 1 dhe nenit 27 të LPP-së, pasi që aktgjykimi objekt i kësaj çështje, është i përbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përbarim, pasi që në të janë treguar palët përkatësisht kreditorët dhe debitori, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Përkitazi me pretendimet e palës debitorë të cekura në prapësimin e tij se i njëjti nuk ka detyrim ndaj kreditorit, dokumenti përbarues – aktgjykimi C.nr. 440/2022 i dt. 11.04.2024, i plotfuqishëm me datë 26.04.2024 dhe i ekzekutueshëm prej datës 27.05.2024, i cili ka tipare të

përmbareshmërisë dhe të ekzekutueshmërisë sipas nenit 36, paragrafi 1 të LPP-së, dhe se aktgjykimi nuk është prishë, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër siç parasheh neni 71 par.1.2 i LPP-së për të qenë aktgjykim pa efekt juridik, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm andaj edhe si të tilla ka krijuar efekt juridik.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbaremore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbaremit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 5 par.5 dhe 73 të LPP-së.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil**  
**PPP.nr.86/2024 datë 23.12.2024**

**Gjyqtarja**  
**Adelina Jusufi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.